

# NDIHMJA JURIDIKE FALAS



## REFORMA NË DREJTËSI MUNDËSON:

RRITJE TË AKSESIT NË DREJTËSI

MBROJTJE MË TË MIRË TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT

Cili ligj rregullon në Shqipëri ndihmën juridike?



Ligji nr.111/2017“Për Ndhimën Juridike të Garantuar nga Shteti”



## Çfarë risish sjell reforma në drejtësi dhe ligji lidhur me ndihmën juridike?

- Zgjerim të rrethit të subjekteve, të cilët përfitojnë ndihmë juridike nga shteti;
- Thjeshtim të procedurave për përfitimin e ndihmës juridike parësore, e cila ofrohet ndër të tjera në formën e këshillimit, përpilimit të dokumenteve, përfaqësimit përpara organeve administrative;
- Ofrim të ndihmës juridike dytësore pas vendimit të gjykatës, nga avokatët e miratuar nga Dhoma Avokatisë së Shqipërisë;
- Krijohet Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas në varësi të Ministrit të Drejtësisë.

## Kush përfiton nga ndihma juridike falas?

1. Çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme sipas kriterëve ligjore.
2. Pavarësisht nivelit të të ardhurave dhe pasurisë përfitojnë ndihmë juridike kategori të veçanta si:
  - Viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e abuzuara seksualisht;
  - Personat që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar;
  - Viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin;
  - Fëmijët, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
  - Personat, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale.

## JU DUHET KËSHILLIM / INFORMIM LIGJOR? DREJTOHUNI PRANË:

- Zyrës për ndihmën ligjore falas pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- Organizatave jofitimprurëse të autorizuara për të ofruar ndihmë juridike;
- Qëndrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore pranë bashkive;
- Klinikave ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.

## KENI NEVOJË PËR AVOKAT NË NJË PROCES GJYQËSOR?

Drejtohuni me një kërkesë pranë gjykatës kompetente, që do të shqyrtojë çështjen gjyqësore për të cilën keni interes ose ku çështja është në proces shqyrtimi.

Pas verifikimit të kriterëve ligjore, gjykata do t'ju mundësojë caktimin e një avokati pa pagesë.

*\* Në gjykatë mund të bëni kërkesë edhe për përjashtim nga pagesa e tarifave/ shpenzimeve gjyqësore.*

